

VENDIM
Nr. 79, datë 15.6.2012

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT “FTESË PËR SHPREHJE INTERESI” QË DO TË SHPALLET
NGA TAP AG NË PËRPUTHJE ME UDHËZUESIN PËR MENAXHIMIN DHE ALOKIMIN E
KAPACITETEVE TË PROJEKTIT TRANSADRIATIK PIPELINE (TAP), SIPAS PARAGRAFIT 6
TË NENIT 36 TË DIREKTIVËS 2009/73/EC**

Në mbështetje të nenit 40 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror” dhe neni 25 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, vendimin nr. 155, datë 19.12.2011, për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga aksesit i palëve të treta, të paraqitur nga ana e kompanisë TAP AG, neni 3 të udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin transadriatik Pipeline (TAP) të miratuar me vendimin nr. 39, datë 23.4.2012 të Bordit të Komisionerëve, duke marrë parasysh gjithashtu që:

- Direktiva 2009/73/EC është e zbatueshme për Italinë dhe Greqinë, si shtete anëtare të Bashkimit Europian dhe është transpozuar në legjislacionin përkatës kombëtar të këtyre vendeve, dhe

- Direktiva 2003/55/EC është e zbatueshme për Shqipërinë, si palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe është transpozuar në legjislacionin kombëtar.

- Këshilli i Ministrave i Komunitetit të Energjisë ka vendosur më 6 tetor 2011, që direktiva 2009/73/EC dhe rregullorja 715/2009, do të duhet të zbatohen nga të gjitha palët kontraktuese brenda vitit 2015;

- Neni 22 i direktivës 2003/55/EC, neni 36 i direktivës 2009/73/EC dhe legjislacioni kombëtar, kërkojnë që në rastin kur infrastruktura në fjalë shtrihet në territorin e më shumë se një vendi, çdo vendim për përjashtim prej së drejtës të aksesit të palëve të treta (TPA), duhet të merren në bashkëpunim mes autoriteteve kombëtare të vendeve përkatëse;

- Neni 3 i udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin transadriatik Pipeline (TAP) të miratuar me vendimin nr. 39, datë 23.4.2012 të Bordit të Komisionerëve, ka përcaktuar detyrimin e miratimit nga ana e autoriteteve rregullatore, të dokumentit “Ftesë për shprehje interesi”, që do të shpallet nga TAP AG, në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit transadriatik Pipeline (TAP).

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.6.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës, në lidhje me dokumentin “Ftesë për shprehje interesi”, që do të shpallet nga TAP AG, në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit transadriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC, që ka rezultuar prej bashkëpunimit të tre rregullatorëve,

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit “Ftesë për shprehje interesi”, që do të shpallet nga TAP AG në përputhje me udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin transadriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC (bashkëlidhur këtij vendimi, dokumenti “Ftesë për shprehje interesi”).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani